



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 46

2003

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.320, datë 15.5.2003	Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.....	1755
Vendim i KM nr.325, datë 21.5.2003	Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.....	1756
Vendim i KM nr.327, datë 15.5.2003	Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.....	1757
Vendim i KM nr.330, datë 29.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....	1758
Vendim i KM nr.331, datë 29.5.2003	Për kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, në përzgjedhjen për marrjen e gradës “Ambasador”.....	1759

Vendim i KM nr.332, datë 29.5.2003	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.....	1759
Vendim i KM nr.333, datë 29.5.2003	Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit.....	1761
Vendim i KM nr.334, datë 29.5.2003	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.....	1762
Vendim i KM nr.337, datë 29.5.2003	Për shfuqizimin e vendimit nr.222, datë 15.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për sistemimin e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor dhe teknik” dhe për mbylljen e Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.....	1769
Vendim i KM nr.339, datë 29.5.2003	Për dhënie fondi ndihmë Partisë Ardhmëria Shqiptare...	1769
Vendim i KM nr.343, datë 29.5.2003	Për blerje karburanti për automjete dhe për ngrohje qendrore, nga ministritë, institucionet qendrore, buxhetore dhe entet në varësi të tyre, të cilat nuk i kanë përdorur fondet e parashikuara në vendimin nr.206, datë 28.3.2003 të Këshillit të Ministrave.....	1770
Vendim i KM nr.387, datë 12.6.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit negociator shqiptar, për përgatitjen e negociatave me Komisionin European dhe shtetet anëtare të Bashkimit European, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit”, i ndryshuar....	1771
Udhëzim i MF	Për tarifat e lejimit, regjistrimit dhe pagesat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse dhe rregullat e zbatimit të tyre.....	1771

V E N D I M
Nr.320, datë 15.5.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT
RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Rrjetit rrugor kombëtar prej 3221 km rrugë (pika 1) i shtohen edhe 136 km rrugë.
2. Lidhjes 1, “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit (pika 1), i shtohen edhe këto emërtime:

“Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Librazhd

- Librazhd-Steblevë 32 km rrugë interurbane, dytësore

Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Bulqizë

- Steblevë-Bulqizë (Ura e Zallit) 39 km rrugë interurbane, dytësore

Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Vlorë

- Kotë-Kuç-k/Sarandë 47 km rrugë interurbane, dytësore

Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Sarandë

- Borsh-k/Vlorë 18 km rrugë interurbane, dytësore.”.

3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale” (pika 4/1) hiqen emërtimet:

- Librazhd-Steblevë

- Steblevë-Bulqizë

- Kotë-Kuç-k/Sarandë

- Borsh-k/Vlorë.

4. Në pikën 7 shtohet edhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.325, datë 21.5.2003

PËR POZICIONIN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM NË MINISTRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sekretari i Përgjithshëm në ministri është nëpunësi civil më i lartë i saj. Emërimi, lirimi nga detyra, vlerësimi i punës, paga, çështjet për disiplinën dhe karrierën e Sekretarit të Përgjithshëm u nënshtrohen dispozitave të përcaktuara nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe akteve nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit.

2. Sekretari i Përgjithshëm, nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe të bashkërendimit të punës

së strukturave të institucionit, kujdeset dhe siguron qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive përkatëse të ministrisë me institucionet e tjera.

3. Sekretari i Përgjithshëm kryen detyra për bashkërendimin e strukturave të ministrisë, për zbatimin e politikave të miratuara në fushën e veprimtarisë së saj. Në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe urdhrat ose detyrat e marra nga ministri, Sekretari i Përgjithshëm merr masa për shfrytëzimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të ministrisë.

4. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit e, në mënyrë të veçantë, për zbatimin e dispozitave të ligjit “Statusi i nëpunësit civil” dhe të çështjeve të tjera lidhur me personelin. Për këtë qëllim ai bashkëpunon, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, me Departamentin e Administratës Publike, në përputhje me aktet normative dhe me udhëzimet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

5. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për vlerësimin dhe parashikimin e nevojave për trajnim, si dhe bën planifikimet për trajnimin e stafit të ministrisë. Sekretari i Përgjithshëm njofton, në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Departamentin e Administratës Publike për nevojat për trajnim dhe ecurinë e veprimtarive trajnuese në ministri.

6. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave personale të punonjësve të ministrisë, për të plotësuar Regjistrin Kombëtar të Administratës Publike.

7. Sekretari i Përgjithshëm ndjek zbatimin e rregullave të etikës dhe të rregullores së brendshme të institucionit nga punonjësit e institucionit, njofton ministrin për rastet e shkeljeve, si dhe rekomandon masat e nevojshme.

8. Sekretari i Përgjithshëm ndjek procesin e përgatitjes së projektakteve normative të fushës së veprimtarisë së ministrisë, mbështetur në programet vjetore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

9. Sekretari i Përgjithshëm ka për detyrë përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga ministria. Ai përgatit analiza dhe bën propozime për mbarëvajtjen e punës së ministrisë.

10. Në përputhje me urdhrat dhe detyrat e caktuara nga ministri, Sekretari i Përgjithshëm përgatit dhe paraqet raporte për veprimtarinë e institucionit ose për çështje të veçanta.

11. Sekretari i Përgjithshëm përfaqëson ministrin në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me delegimet dhe autorizimet e dhëna nga ministri.

12. Përveç detyrave dhe përgjegjësi të përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm kryen edhe detyra të tjera të ngarkuara nga ministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr.327, datë 15.5.2003**

PËR KALIMIN E SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË VARËSI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 12 të nenit 6 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të nenit 14 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 16 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimi i sistemit të paraburgimit, së bashku me mjediset dhe pajisjet, nga administrimi i

komisariateve të Ministrisë së Rendit Publik në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë.

2. Numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Rendit Publik t'i zbriten 322 punonjës.

3. Numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë t'i shtohen 322 punonjës, të cilët do të shërbejnë në dhomat e paraburgimit.

4. Ministrisë së Rendit Publik, nga buxheti i miratuar për vitin 2003, t'i zbritet fondi prej 154 200 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e dyqind mijë) lekësh, të ndara në zërat e mëposhtëm:

a) Paga 80 200 000 (tetëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë;

b) Sigurime shoqërore 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë;

c) Shpenzime operative 52 000 000 (pesëdhjetë e dy milionë) lekë.

5. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t'i shtohet ky fond, sipas zërave të caktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Marrja në dorëzim e mjediseve të paraburgimit të bëhet veçmas për çdo komisarjat. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Rendit Publik të përcaktojnë radhën e marrjes në dorëzim, masat që do të merren dhe mënyrat e kryerjes së këtij dorëzimi.

7. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Rendit Publik të përcaktojnë mënyrën e kryerjes së shërbimeve të nevojshme për funksionimin normal të paraburgimit, kur këto mjedise gjenden brenda hapësirave të komisarjateve.

8. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.330, datë 29.5.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 pika 2 paragrafi i dytë e 83 paragrafi i tretë të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen nr.8 "Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë" të bëhen shtesa dhe ndryshime, si më poshtë vijnë:

a) Në listën "Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta), të shtohen shtetet:

"- Bullgaria- Kroacia - Estonia

- Çekia - Polonia- Letonia

- Hungaria- Rumania- Lituania

- Sllovenia - Sllovakia."

b) Në listën "Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë dhe pa pagesë, (kur udhëtojnë me pasaportë diplomatike ose shërbimi)" aty ku thuhet Italia dhe Rumania, të hiqet shënimi "vetëm diplomatike."

2. Në lidhjen 8/1, "Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë", pikat 1 e 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit e huaj me kombësi shqiptare hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 1 qershor deri më 30 shtator, pa vizë, duke i paraqitur policisë kufitare çdo dokument të vlefshëm udhëtimi.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 1 qershor deri 30 shtator, hyjnë pa vizë shtetasit e shteteve të mëposhtme:

Serbi–Mali i Zi

Bosnjë-Hercegovinë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.331, datë 29.5.2003

PËR KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË PËRZGJEDHJEN PËR MARRJEN E GRADËS “AMBASADOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 29 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, në përzgjedhjen për marrjen e gradës “Ambasador”, duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) të kenë vjetërsi pune mbi 15 vjet në shërbimin e jashtëm;
- b) të kenë stazh shërbimi në post drejtues në shërbimin e jashtëm, jo më pak se 10 vjet;
- c) të plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të pikës 1, të nenit 31 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ç) të kenë punuar në shërbimin e jashtëm për 5 vitet e fundit në vazhdimësi;
- d) të jenë dekretuar “Ambasador” jo më pak se 3 herë;
- dh) të marrin vlerësim maksimal në aftësi profesionale dhe në rezultatet e punës.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.332, datë 29.5.2003

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.326, DATË 21.6.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E TRAJTIMIT TË INVALIDËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Invalidët e luftës gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat e kurimit, që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas të gjitha barnat, sipas recetës së mjekut.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat si më poshtë vijnë:

“5/a. Invalidët e luftës me gjymtime të rënda, në pamundësi të kurimit brenda vendit, të diagnostikohen e kurohen jashtë shtetit, sipas vendimit të komisionit ndërspitalor, që funksionon pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

5/b. Invalidët e luftës të pajisen falas nga Ministria e Shëndetësisë me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse, të përshtatshme për ta.

5/c. Udhëtimi i invalidëve të luftës me mjetet e transportit qytetës, publik bëhet falas, ndërsa me mjetet e transportit ndërqytetës të bëhet duke paguar gjysmën e vlerës së biletës, kundrejt paraqitjes së dëshmisë së invalidit. Për rastet kur këto transporte janë private organet përkatëse, në kontratat me subjektet private, parashikojnë efektet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj pike.

5/ç. Kur invalidi i luftës vdes, komuna ose bashkia i bën nderimet përkatëse dhe përballon shpenzimet e varrimit, duke i dhënë familjes së të ndjerit 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Në shpenzimet e varrimit përfshihen arkivoli, transporti, qëndrimi në morg, ceremonia dhe dreka.

5/d. Organet e qeverisjes vendore trajtojnë me strehim, me përparësi, familjet e konsideruara të pastreha, që në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa shtesa në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” kanë në përbërje të tyre invalid, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.”.

3. Pas pikës 7, shtohen pikat si më poshtë vijnë:

“7/a Departamenti i veteranëve e invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe dëshmorëve të atdheut, në Ministrinë e Mbrojtjes, ndjek zbatimin e politikave të qeverisë për përkujdesjen ndaj invalidëve të luftës, sipas të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

7/b Deklarimi i invalid lufte nga Komisioni i Ekspertizës Mjekoligjore dhe përcaktimi në grupin përkatës konsiderohen të mbyllura.”.

4. Pika 8 ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.”.

5. Ngarkohen ministratë e përmendura më sipër të kryejnë procedurat ose të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M Nr.333, datë 29.5.2003

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrisë të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3) e lidhjes nr.1 është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5, 6) të lidhjes nr.1 jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Shtetit.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik” nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.9.2003.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit

Lidhje 1

Roli	Grada	Paga bazë(për gradë)	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
			Në funksione të policisë	Në funksione operuese N.shpejtë	Në funksione operuese F.speciale
1	2	3	4	5	6
Bazë	Agjent	24800	4000	7000	30000
	Agjent i I-rë	25800	4000	7000	35000
	Asistent	26800	4000	8000	42000
	Asistent i I-rë	27800	4000	8000	44000
	Kryeasistent	28800	4000	8000	44000
I Mesëm	Nëninspektor	37000	4000	6000	38000
	Inspektor	39000	4000	6000	38000
	Kryeinspektor	44000	4000	6000	38000
I Lartë	Nënkomisar	54000	4000	6000	31000
	Komisar	67000	4000	6000	31000
	Kryekomisar	77000	4000	6000	31000
Madhor	Drejtues	87000	8000	10000	
	Zv/Drejt.Përgjithshëm	103000	15000		
	Drejtor i Përgjithshëm	124500	20000		

V E N D I M

Nr.334, datë 29.5.2003

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I I SEGMENTIT RRUGOR PIRAJ-KTHESA VAU I DEJËS, PJESË E SUPERSTRADËS LEZHË-SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 134 422 m2 tokë arë, 400 m2 tokë truall, 315 m2 sipërfaqe objektsh, 2 134 432 lekë kultura bujqësore, 1 695 100 lekë dru frutor dhe 4 477 500 lekë pyje dhe kullota, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 136 950 335 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 554 000 (pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekësh.
5. Fondi prej 137 504 335 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e katër mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimeve procedurale sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit
6. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve që vërtetojnë pronësinë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.
7. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda datës 30.6.2003.
8. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe të Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU: SHKODER dhe LEZHE

Lista e pronareve qe shpronosen per shkak te ndertimit te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder
(Seksioni IV Piraj - Bushat)

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke bujqesore, Truall, Ndertese, Kullote, Pyje Nr. (1-181)

[illegible]

[illegible]

[illegible]

9	Jak	om	Tu	Tuk	8/11	6	13	258	60	1	056									314	61	m
0	Ndoc	alok	P	Fili	8/10	12	13	2256	10	1	792									4048	10	
1	Lazer	alok	P	Fili	8/9	6	13	388	69	1	216									604	70	m
2	Hider	ustaf	M	Sh	8/8	28	13	6864	11	2	048									8912	11	
3	Shaba	ider	H	Sh	8/7	07	13	8991	18	3	312									2303	19	
4	Xhevat	aut	D	Sh	8/6	66	13	2858	24	4	256									7114	24	
5	Zydi	aut	D	Sh	8/5	01	13	3513	18	3	216									6729	18	
6	Fari	aut	D	Sh	8/4	71	13	7423	24	4	336									1759	25	
7	Gani	ustaf	M	Sh	8/3	49	13	6037	13	2	384									8421	13	
8	Haxhi	iza	R	Os	8/2	48	13	9024	40	7	168									6192	41	
9	Ali	iza	R	Os	8/1	36	13	3268	76	1	3376									6644	77	
0	Asllan	enel	Z	Da	2/20	748	13	95924	15	2	7968									23892	16	
1	Lutfi	eli	V	Da	2/13	57	13	2441	78	1	3712									6153	79	m
2	Ramad	amil	C	Os	2/11	374	13	54462	12	2	1984									76446	12	
3	Xhelad	iza	R	Os	2/30	73	13	7949	15	2	768									0717	16	m

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

71	p	amadan	vizi	6/14	5	13	085	20	500										305	
72	Zef	jon	Cdra	Ko	6/3	41	13	2633	056	7									40	
73	Nuri	alit	Hvizi	Per	6/12	38	13	9894	008	7	3								40	
74	Nazif	alit	Hvizi	Per	6/11	06	13	9378	896	4									28	
75	Berhan	alit	Hvizi	Per	6/5	17	13	8121	472	3	3								20	
76	Pjeter	ole	Ka	Lek	6/13	65	13	3245	840	5									33	
77	Anton	ark	Mdaj	Do	6/8	5	13	085	20	7									41	
78	Agron	hmet	Avizi	Per	8/1	5	13	085	20	7									41	m
79	Ahmet	uh	Nvizi	Per	8/2	9	13	607	24	6									36	d
80	Pjerin	ark	Mrgji	Gje	7/21										0		00000	6	60	an
81	Lumni	alit	Hvizi	Per	7/19	2	13	996	472	1									85	

SH

12

1

1

7

4

13

UMA

34422

2727286

761472

631600

00

00

40000

15

223503

4925

00

477500

8261361

Mbyllet me numer rendor 181 (njeqindetetehjetenje)

V E N D I M
Nr.337, datë 29.5.2003

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.222, DATË 15.5.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SISTEMIMIN E INFORMACIONIT DHE TË DOKUMENTACIONIT
SHKENCOR DHE TEKNIK” DHE PËR MBYLLJEN E QENDRËS SË INFORMACIONIT
DHE TË DOKUMENTACIONIT SHKENCOR DHE TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” dhe të neneve 121 e 124 të Kodit të Procedurave Administrative, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.222, datë 15.5.1995 të Këshillit të Ministrave.
 2. Mbylljen e Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.
 3. Mjediset, fondi i dokumentacionit dhe buxheti i mbetur i vitit 2003 i Qendrës së Informacionit dhe Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik të administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
 4. Për punonjësit që janë në marrëdhënie pune me këtë qendër të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.339, datë 29.5.2003

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTISË ARDHMËRIA SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Partisë Ardhmëria Shqiptare t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare në çastin e krijimit.
 2. Ky fond të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2003, miratuar për partitë politike.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.343, datë 29.5.2003

Për blerje karburanti për automjete dhe për ngrohje qendrore, nga Ministrinë, institucionet qendrore, buxhetorë dhe entet në varësi të tyre, të cilat nuk i kanë përdorur fondet e parashikuara në vendimin nr.206, datë 28.3.2003 të Këshillit të ministrave

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministritë, institucionet qendrore, buxhetore dhe ato të varësisë, të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi nuk i kanë përdorur, tërësisht ose pjesërisht, fondet e parashikuara në vendimin nr.206, datë 28.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për blerje karburanti për automjete dhe për ngrohje qendrore nga ministritë, institucionet qendrore, buxhetore dhe entet në varësi të tyre, me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë””, t’i përdorin këto fonde, deri më 1 korrik 2003, me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” si më poshtë vijon:

a) Me shoqërinë “ARMO” sh.a., Fier, për blerje gazoili (naftë) për furnizimin e automjeteve me tallona, kundrejt çmimit 65 lekë/litër dhe për blerje gazoili (naftë) për furnizimin e automjeteve dhe për ngrohje qendrore, me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 57 lekë/litër.

b) Me shoqëritë “Petrolimpex” sh.a., Tiranë, për blerje gazoili (naftë) importi, për furnizimin e automjeteve me tallona, kundrejt çmimit 80 lekë/litër dhe për blerje gazoili (naftë) importi për furnizimin e automjeteve dhe për ngrohje qendrore, me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 70 lekë/litër.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore, buxhetore dhe ato të varësisë, si dhe shoqëritë anonime “Armo” dhe “Petrolimpex” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.387, datë 12.6.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.215, DATË 16.5.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NEGOCIATOR
SHQIPTAR, PËR PËRGATITJEN E NEGOCIATAVE ME KOMISIONIN EUROPIAN DHE
SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN, PËR NËNSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 29 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 2 e vendimit nr.215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

U D H Ë Z I M

PËR TARIFAT E LEJIMIT, REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT DHE KALIBRIMIT TË MJETEVE MATËSE DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 15 të ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 “ Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, Ministri i Financave,

U D H Ë Z O N:

1. Personat fizikë ose juridikë që prodhojnë mjete matëse, importojnë ose i përdorin ato janë të detyruar të paguajnë tarifën dhe pagesat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Për miratimin e tipit të mjetit matës ose për lejimin e atyre që importohen, miratohen tarifën dhe pagesat e përcaktuara në pasqyrën nr.1.

Nëse tipi i mjetit matës të paraqitur për miratim nuk përputhet me kërkesat teknike të regjistruara, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e pikës “a” dhe gjysmën e tarifës së pikës “b”.

Tarifën e miratimit të tipit paguhet edhe kur tipi i mjetit matës në përfundim nuk plotëson kërkesat për miratim.

Kur importohen mjete matëse, importohen tarifën dhe pagesat e përcaktuara në pikën 2 të pasqyrës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

3. Për regjistrimin e mjeteve matëse miratohen tarifën dhe pagesat e përcaktuara në pasqyrën nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Për verifikimin e kalibrimit fillestar ose periodik të mjeteve matëse miratohen pagesat e përcaktuara në pasqyrën 3 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Pagesat e verifikimit, të kalibrimit fillestar ose periodik, llogariten për copë, për çdo pronar ose administrues të marrë veç e veç, si dhe për mjete matëse të të njëjtit tip dhe që verifikohen ose kalibrohen në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.

Kur sasia e mjeteve matëse të të njëjtit tip që verifikohet ose kalibrohet është më e madhe se një copë, pagesa llogaritet nga produkti i pagesës përkatëse për copë me numrin e copave të këtij tipi mjeti matës, kur nuk paraqitet ndryshe në pasqyrën përkatëse.

Kur puna verifikuese ose kalibruuese ndërpritet për shkak të pronarit ose administruesit, pagesa për copë llogaritet mbi bazën e numrit të mjeteve matëse që janë verifikuar ose kalibruar faktikisht nga ai tip.

5. Për rastet kur kërkohet kryerja e menjëhershme e miratimit, lejimit, verifikimit ose kalibrimit të mjeteve matëse dhe bihet dakord për kohën e kryerjes, paguhet dyfishi i tarifës ose pagesës përkatëse të përcaktuara në pasqyrat nr.1 dhe 3, që i bashkëngjiten këtij udhëzimi.

6. Për rastet kur kërkohet kryerja e miratimit, lejimit, verifikimit ose kalibrimit të paplanifikuar për t'u futur në grafik dhe për të kryer procedurat përkatëse paguhet 1,5 fishi i vlerave përkatëse të përcaktuara në pasqyrat nr.1 dhe nr.3, që i bashkëngjiten këtij udhëzimi.

7. Personi fizik ose juridik që detyrohet të kryejë verifikimin ose kalibrimin e mjeteve matëse që ka në përdorim, përballon dhe shpenzimet shtesë të mëposhtme:

a) për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë:

i) lëvizjen e bazës verifikuese;

ii) fuqinë punëtore ndihmëse.

b) për vagonçisternat, autobotet dhe rezervuarët:

i) materialet e nevojshme ndihmëse;

ii) pagesën për shfrytëzimin e peshores së përdorur për verifikim.

8. Për rastet kur personi fizik ose juridik ka rënë dakord me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit për vendin dhe kohën e kryerjes së verifikimit ose kalibrimit dhe puna nuk mund të fillojë, nuk mund të vazhdojë ose fillon me vonesë, pasi personi fizik ose juridik nuk i ka realizuar ose i ka realizuar me mangësi detyrimet e tij për përgatitjen paraprake, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.4, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

9. Kur personi fizik ose juridik njofton për moszbatimin e planifikimit të verifikimit ose kalibrimit të mjeteve matëse, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit ka filluar punën përgatitore për kryerjen e verifikimit ose kalibrimit, paguhet pagesa sipas pasqyrës nr.4 që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

10. Kur gjatë verifikimit ose kalibrimit mjete matës nuk i përgjigjet udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, ai nuk vulolet dhe paguhet gjysma e pagesës përkatëse.

11. Kur mjetet matëse të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit për verifikim ose kalibrim nuk tërhiqen nga prurësi brenda afateve të caktuara, ky i fundit i paguan Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit për magazinim një shtesë prej 2 për qind për çdo mjet matës, për çdo ditë, të pagesës përkatëse të verifikimit ose kalibrimit.

Kur procesi i miratimit, lejimit, regjistrimit apo verifikimit ose kalibrimit të mjeteve matëse zgjat më shumë se afati i parashikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, personit fizik ose juridik i zbritet 2 për qind e tarifës ose pagesës përkatëse për çdo ditë vonese dhe për çdo mjet.

12. Tarifat e miratimit, lejimit dhe regjistrimit, si dhe pagesat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse derdhen në bankë në numrin e llogarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, drejtorive rajonale, degëve, zyrave ose i paguhen me çek ose me para në dorë punonjësit që kryen procesin përkatës përkundrejt mandatarkëtimit të lëshuar prej tij.

13. Për kontrollin e produkteve të paketuara paguhen tarifën e miratuara sipas pasqyrës nr.5 të këtij udhëzimi.

14. Për kryerjen e procedurave të lejimit të reparteve të riparimit dhe autorizimit të laboratorëve, si dhe të inspektimit vjetor të tyre paguhen tarifën e përcaktuar në pasqyrën nr.6 të këtij udhëzimi.

15. Për mjetet matëse, të cilat nuk përfshihen në pasqyrat bashkëngjitur, tarifa ose pagesa do të përllogaritet me kohën e punës së nevojshme për verifikim ose kalibrim, shumëzuar me shumën orare të pagesës, e cila është 1500 lekë.

16. Për subjekte që janë paguese të TVSH-së dhe kërkojnë dokument me TVSH, tarifave ose pagesave të paraqitura në pasqyrat e këtij udhëzimi u shtohet edhe vlera e TVSH-së.

17. Lejohet të punohet me tarifa provizore të përcaktuara nga DPMK-ja për një periudhë tremujore, për rastet e hapjes së veprimtarive të reja. Me kalimin e kësaj periudhe, pa u miratuar tarifa ose pagesa përkatëse nga Ministria e Financave, funksionimi i veprimtarisë së re ndërpritet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Kastriot Islami

Pasqyra nr.1

**Tarifat e procedurave të miratimit të prodhimit (lejimit të importimit) të tipit të mjetit matës
përsa i përket karakteristikave metrologjike**

Për prodhimin në vend të mjeteve matëse:

Për shqyrtimin dhe pranimin e dokumenteve 6000 lekë
për miratimin e tipit

b) Për verifikimin e treguesve metrologjikë të tipit paguhet dyfishi i vlerës së përcaktuar në pasqyrën nr.3 të këtij vendimi.

c) Për shpalljen e miratimit të tipit:

- Për çdo faqe të daktilografuar 100 lekë

- Për çdo skemë 200 lekë

- Për çdo fotografim 500 lekë

e) Nëse tipi i paraqitur nuk përputhet me kërkesat teknike të regjistruara, procedura e punës ndërpritet dhe subjekti paguan tarifën e pikës (a) dhe gjysmën e tarifës së pikës (b).

Për mjetet matëse të importuara:

a) Për shqyrtimin dhe njohjen e dokumenteve 6000 lekë
të miratimit të tipit dhe atyre teknike
Për konstatimin e përputhshmërisë së kërkesave teknike
me tipin e importuar:

- | | |
|---|---|
| - Për çdo grup prej 5 mjeteve matëse | paguhet 10 për qind e çmimit të blerjes së një
mjeti |
| - Për çdo grup prej 5 lodra fati
(lodra,elektronike, ruleta, bingo etj.) | 3000 lekë |

Pasqyra nr.2

Tarifat e regjistrimit të mjeteve matëse

Regjistrimi i mjeteve matëse:

- Për çdo mjet matës ose lodër fati 300 lekë
- Për gramare ose masa vëllimore seri, deri në 5 copë 300 lekë
- Për çdo gramar ose masë vëllimore shtesë 50 lekë

Pasqyra nr.3

Pagesa për verifikim a kalibrim fillestar ose periodik të mjeteve matëse

1. Mjete matëse të gjatësisë, shpejtësisë dhe numrit të rrotullimeve.

Metra Lekë për copë

deri në 1 m 600

mbi 1 m 800

Metra shirit prej metali ose materialesh të tjera verifikuese

deri në 5 m 1200

mbi 5 m deri 50 m 3000

mbi 50 m 7500

Për sasi mbi 10 copë mjete matëse të pikave 1.1 dhe 1.2 bëhet zbritja si më poshtë:

për 11 copë deri në 20 copë	10 për qind
-----------------------------	-------------

për 21 copë deri në 50 copë	15 për qind
-----------------------------	-------------

mbi 50 copë	20 për qind
-------------	-------------

1.4 Aparate matëse taksimetra 3000

1.5 Mjet matës (radar) për verifikimin e shpejtësisë të automjeteve 10000

Masa vëllimore për lëndë të thata, vëllimi i të cilave del me përllogaritje:

1 masë vëllimore 3000

1 nënndarje e masës vëllimore 1500

çdo nënndarje tjetër shtesë 1200

3. Masa vëllimore për lëngje në të cilat është shënuar kufiri i vëllimit
(bëjnë përjashtim pikat 5 dhe 6)

3.1 Verifikim vëllimi	Numri i copëve	Lekë për copë
deri 1 dm ³	deri në 5	350
	6 deri 20	320
	21 deri 100	300
	mbi 100	280
mbi 1 dm ³ deri në 5 dm ³	deri në 5	450
	6 deri 20	400

	21 deri 100	350
	mbi 100	300
mbi 5 dm3 deri 10 dm3	deri në 5	700
	6 deri 20	600
	21 deri 100	500
	mbi 100	450
mbi 10 dm3 deri 20 dm3	deri në 5	1000
	6 deri 20	800
	21 deri 100	700
	mbi 100	600
mbi 20 dm3 deri 50 dm3	deri në 5	1400
	6 deri 20	1200
	21 deri 100	1000
	mbi 100	900
mbi 50 dm3 deri 100 dm3	deri në 5	1800
	6 deri 20	1600
	21 deri 100	1400
	mbi 100	1200

Gjatë procesit të kalibriminimit për çdo nënndarje që bëhet në enët vëllimore të pikës 3, paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse për verifikimin e vëllimit të plotë.

4. Masa vëllimore për lëngje në të cilat kufiri i vëllimit do të përcaktohet nga verifikimi.

Në këtë rast pagesa përfshin vizimin dhe tregimin e vëllimit (bëjnë përjashtim pikat 5 dhe 6)

Verifikim vëllimi	Numri i copëve	Lekë për copë
deri 1 dm3	deri në 5	700
	6 deri 20	600
	21 deri 100	500
	mbi 100	400
mbi 1 dm3 deri në 5 dm3	deri në 5	800
	6 deri 20	700
	21 deri 100	350
	mbi 100	300
mbi 5 dm3 deri 10 dm3	deri në 5	900
	6 deri 20	850
	21 deri 100	800
	mbi 100	750
mbi 10 dm3 deri 20 dm3	deri në 5	1200
	6 deri 20	1150
	21 deri 100	1100
	mbi 100	1050
mbi 20 dm3 deri 50 dm3	deri në 5	1500
	6 deri 20	1400
	21 deri 100	1300
	mbi 100	1200
mbi 50 dm3 deri 100 dm3	deri në 5	1750
	6 deri 20	1650
	21 deri 100	1550
	mbi 100	1450

Gjatë procesit të kalibriminimit, për çdo nënndarje që bëhet në enët vëllimore të pikës 4 paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse për verifikimin e vëllimit të plotë.

5. Masa qelqi dhe porcelani me vëllim deri në 5 dm3.

1 dm3	deri 5	500
	6 deri 20	400
	21 deri 100	300
	mbi 100	250
mbi 1 dm3 deri 5 dm3	deri 5	600
	6 deri 20	500
	21 deri 100	400
	mbi 100	350

Për masa qelqi me ngjyrë ose pa ngjyrë, por të tejdukshme, vlejnjë pagesat e vendosura në pikën 5.

Për masa qelqi jo të tejdukshme dhe porcelani, pagesa e verifikimit të tyre është sa dyfishi i atyre të vendosura në pikën 5.

6. Voza, damixhanë, shishe me vëllim mbi 5 dm3, rezervuarë, bote, autobote, vagonçisterna.

6.1 Voza, damixhanë, shishe rezervuarë.

Verifikim vëllimi Lekë për copë

deri 50 dm3	1250	
mbi 50 dm3 deri 100 dm3		1500
mbi 100 dm3 deri 200 dm3		2000
mbi 200 dm3 deri 300 dm3		2500
mbi 300 dm3 deri 400 dm3		3000
mbi 400 dm3 deri 500 dm3	3500	
mbi 500 dm3 deri 600 dm3	4000	
mbi 600 dm3 deri 700 dm3	4500	
mbi 700 dm3 deri 800 dm3	5000	
mbi 800 dm3 deri 900 dm3	5500	
mbi 900 dm3 deri 1000 dm3	6250	

Për verifikimin e vozave prej druri, nëse janë të nevojshme punët plotësuese (fshirja e shënimeve të mëparshme etj.), pagesa rritet 25 për qind e pagesës përkatëse të pikës 6.1.

6.2 Kur verifikimi i enëve vëllimore të pikës 6.1 bëhet në vendpërdorim (birrari, punishte etj.) dhe pronari ose administruesi vë në dispozicion pajisjet e nevojshme dhe kryen punët ndihmëse, pagesa ulet me 50 për qind të pagesës përkatëse të vendosur në pikën

6.1.

6.3 Autobote dhe rezervuarë

Verifikim vëllimi Lekë për copë

deri 5000 dm3	7000
mbi 5000 dm3 deri 10 000 dm3	8000
mbi 10 000 dm3 deri 15 000 dm3	9000
mbi 15 000 dm3 deri 20 000 dm3	10000
mbi 20 000 dm3 deri 25 000 dm3	11000
mbi 25 000 dm3 deri 30 000 dm3	12 000
mbi 30 000 dm3	13 000

6.4 Vagonçisterna

Verifikim vëllimi

Lekë për copë

deri 25 000 dm3	16 000
mbi 25 000 dm3	20 000

6.5 Për verifikimin e enëve vëllimore, autoboteve, autoçisternave me shumë nënndarje (gryka mbushjeje) të veçanta, të ndara nga njëra-tjetra, kur verifikimi i nënndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës për kapacitet të plotë të enës vëllimore të autobotit, të autoçisternës i shtohet pagesa prej 50

për qind për verifikimin e vëllimit përkatës të çdo nënndarjeje (grykë mbushjeje) të dhënë në pikat 6.1, 6.3 e 6.4.

6.6 Gjatë procesit të kalibrimin, për çdo nënndarje që bëhet në enët volumore, autobotet, autoçisternat dhe rezervuarët, paguhet një shtesë sa gjysma e pagesës përkatëse të verifikimit të vëllimit të plotë.

7. Aparatë të shpërndarjes së karburanteve

Verifikim vëllimi Lekë për copë

- distributorë	7000
- njehsorë (kontatorë)	12000

8. Aparatë të matjes së ujit dhe produkteve ushqimore të lëngëta

- njehsor, kapaciteti deri 5 m³ 100

- njehsor, kapaciteti mbi 5 m³ 400

9. Gramare

9.1 Klasa M3

deri 500 g 100

1kg, 2kg 100

5 kg 150

10 kg 180

20 kg 220

50 kg 300

500 kg 3000

1000 kg 4000

9.2 Klasat M1 dhe M2

Për verifikimin e gramareve të klasave të mësipërme bëhet dyfishi i pagesës përkatëse të dhënë në pikën 9.1.

9.3 Për punime kalibrimi (shtim ose pakësim materiali në vrimën e gramarit) pastrime, heqje vule etj., paguhet një shtesë 100 për qind mbi pagesat përkatëse të pikave 9.1 dhe 9.2

10. Peshore Lekë për copë

10.1 Peshore elektronike analitike dhe saktësisë,

peshore analitike dhe saktësie me krahë 4000

10.2 Peshore elektronike dhe me fushë të shkallëzuar

deri 1 kg 1000

mbi 1 kg deri 10 kg 1400

mbi 10 kg deri 100kg 1800

mbi 100 kg 2200

10.3 Peshore me krahë të barabartë

deri 1 kg 800

mbi 1 kg deri 10 kg 1000

mbi 10 kg deri 50 kg 2000

10.4 Peshore me platformë

deri 250 kg 2500

mbi 250 kg deri 500 kg 2800

mbi 500 kg deri 1000 kg 3200

mbi 100 kg deri 2000 kg 4000

mbi 200 kg deri 5000 kg 5000

mbi 5000 kg deri 10000 kg 6000

mbi 10 t deri 20 t 7000

mbi 20 t deri 30 t 10000

mbi 30 t deri 50 t 13000

mbi 50 t deri 120 t 16000

mbi 120 t 20000

10.5 Peshore dinamometrike

deri 5 kg 750

mbi 5 kg deri 25 kg 1250

mbi 25 b kg deri 100 kg2000
 mbi 100 kg2500
 10.6 Kandarë me bisht
 deri 5 kg750
 mbi 5 kg deri 25 kg1250
 mbi 25b kg deri 100 kg2000
 mbi 100 kg2500
 11. Mjete matëse elektrike
 11.1 Elemente normale4000
 11.2 Rezistenca kampione2000
 11.3 Aparate elektrike të tensionit, të rrymës, të fuqisë,
 të këndit, humbjeve elektrike, të frekuencës etj.:
 - klasa e saktësisë 0.5 dhe më mirë1000
 - klasa e saktësisë 1 dhe më e ulët500

 11.4 Aparate matëse me dekada rezistencash
 - për çdo dekadë, për aparate të klasës së
 saktësisë 0.5 dhe më të mirë2000
 - për çdo dekadë për aparate të klasës së saktësisë
 1 dhe më të ulët1000
 12. Njehsorë elektrikë
 12.1 Njehsorë elektrikë të klasës së saktësisë 0.5 e më të mirë
 - njehsorë njëfazorë2000
 - njehsorë shumëfazorë4000
 - njehsorë elektrikë me transformator5000
 - njehsorë shumëtarifor5000
 12.2 Njehsor elektrik të klasës së saktësisë 1 dhe 2
 - Njehsorë njëfazorë100
 - Njehsorë shumëfazorë200
 14. Lodra të fatit me fitim
 14.1 Lodra fati mekanike2000
 14.2 Lodra fati elektromekanike dhe elektronike3000
 14.3 Bingo70 000
 14.4 Lodra fati elektronike me disa pozicione (ruleta,
 21-sh etj.).
 - për çdo pozicion4000
 14.5 Gogla bingoje
 - për çdo gogël150
 15. Mjete matëse të rrezatimeve jonizuese
 15.1 Aparatet radiodiagnostikuese
 - radiografi10 000
 - radioskopi10 000
 - fluoroskopi10 000
 - mamografi10 000
 - radiografi dentare10 000
 - tomografi etj.10 000
 15.2 Dozimetrat
 - dozimetër radiodiagnostik7000
 - dozimetër radioterapik7000
 15.3 Të tjera
 - radiometër4000
 - monitorë4000
 - indikatorë portabël4000
 16. Mjete matëse në tërheqje, shtypje e prerje
 deri në 100 kN15 000

- mbi 100 kN deri 10 MN25 000
17. Mjete matëse të provave të fortësisë së materialeve (makinat e provave të fortësisë së materialeve
 për HB ose HV5000
 për HR ose metoda të tjera6000
 për majat depërtuese të provave të fortësisë1000
 për pllakat etalone të fortësisë1000
18. Mjete matëse të fushës së presionit
 18.1 Manometrat e presionit të gomave të makinave1500
 18.2 Manometrat e zakonshëm të presionit3000
19. Mjete matëse të fushës së temperaturës
 19.1 Termometra rezistence me sensor platini, bakri etj.2000
 19.2 Termometra me termoçifte2000
20. Mjete matëse të fushës së matjeve fiziko-kimike
 20.1 Refraktometrat
 - refraktometër2500
 - refraktometër portativ1500
 20.2 Mjete matëse për verifikimin e gjëndjes së drejtuesit të automjetit në varësi të përdorimit të substancave alkoolike (etilometër)12 000
 20.3 Polarimetër
 - polarimetër manual6000
 - polarimetër automatik7500
 20.4 Viskozimetër
 - viskozimetër prej qelqi5000
 - viskozimetër mekanik rotativ8000
 20.5 Fotokolorimetër4000
 20.6 Lagështimatësit
 - lagështimatës i drurit5000
 - lagështimatës i farërave të drithërave dhe atyre vajore7000
 20.7 Spektrometër dhe spektrofotometër (të të gjitha llojeve)15 000
 20.8 Gaz kromatograf30 000
 20.9 Gaz analizator20 000
 20.10 Absorbër atomik20 000
 20.11 pH-metër5000
21. Mjete matëse optike
 21.1 Mikroskopë2500

Pasqyra nr.4

Mosplotësimet e detyrimeve

- | | |
|---|---|
| 1. Puna për verifikim ose kalibrim të mjetit matës: | |
| - nuk mund të fillojë ose të ndërpritet | merret 25 për qind e pagesës përkatëse |
| - fillon me vonesë dhe për çdo orë pune të vonuar | paguhet 1000 lekë |
| 1. Moszbatimi i një shërbimi të planifikuar: | |
| - kur puna përgatitore nuk ka filluar | paguhet 3 për qind e pagesës përkatëse |
| - kur puna përgatitore ka filluar | paguhet 10 për qind e pagesës përkatëse |
| - kur puna përgatitore ka mbaruar | paguhet 20 për qind e pagesës përkatëse |

Pasqyra nr.5

Tarifat e kontrollit statistikor të produkteve të paketuara

1. Kontroll pa shkatërrim i produkteve të paketuara të lëngëta, të ngurta ose të gazta:

1.1 Kur nuk merret në konsideratë ambalazhimi për parti:

deri 3200 pako 5000 lekë

mbi 3200 pako 10000 lekë

1.2 Kur ambalazhimi merret në konsideratë:

deri 3200 pako 7000 lekë

mbi 3200 pako 12000 lekë

1.3 Kur prova kryhet për të dytën herë paguhet plus edhe 20 për qind e tarifës respektive.

Kontroll me shkatërrim i produkteve të paketuara të lëngëta, të ngurta ose të gazta:

2.1 20 copë për parti prodhimi 7500 lekë

Pasqyra nr.6

Tarifat e procesit të lejimit të reparteve të riparimit ose autorizimit të laboratorëve, si dhe të inspektimit vjetor të tyre

Procesi i lejimit të reparteve të riparimit ose të

autorizimit të laboratorëve 50 000 lekë

Inspektimi vjetor 25 000 lekë

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 19.6.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë